



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe nenin 11 lidhur me nenin 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me numër 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) – Komuna e Gjakovës shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE
për mbështetje të kërkesave për botimin dhe promovimin e librave

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë personat fizik/autorë të Komunës së Gjakovës, kërkesat e të cilëve janë të fokusuar për botimin dhe promovimin e librave, të aplikojnë për mbështetje financiare.

1. Objektivat e Thirrjes dhe Prioritetet për Ndarjen e Fondeve:

Objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë që Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të ofrojë përkrahje për Individët (autor), kërkesa e të cilëve është e fokusuar në botimin e librave duke ofruar mbështetje me transparencë të plotë.

Objektivat specifike të thirrjes janë:

- Të fuqizohen krijuesit e rinj, që përmes punës së tyre të afirmojnë personalitetin e tyre krijues.
- Të motivohen për krijimtari artistike, studim dhe hulumtim.
- Të bëhet bashkëpunimi me individ për aktivitete në qasje me publikun, për prezantim individual në dobi të shoqërisë.
- T'i kontribuohet letërsisë artistike me vlera letrare, të pranueshme, të qëndrueshme dhe kulturë elitare.
- Të synohet promovimi i veprave letrare të autorëve vendor të cilët me veprat e tyre kanë bërë emër në letërsinë tonë dhe më gjerë.

2. Planifikimi i mbështetjes së kërkesave për një autor do të vlerësohet varësisht nga gjinia letrare, si më poshtë:

Kritikë letrare, Studim, Prozë, Poezi, Dramë

Vlera maksimale e lejuar për një përfitues është deri 1.000 euro.

Personi i cili konkurren ka të drejtë të aplikoj veç me një vepër.

3. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike:

- Të drejtë aplikimi kanë individët/ autorët të cilat janë banorë të Komunës së Gjakovës;
- Individët mund të subvencionohen për botim të librit vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Gjakovës.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete për gjatë këtij viti, dhe të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike:

- Aplikacioni për projekt/propozim;
- Projekt buxheti;
- Deklarata për financim të dyfishtë;
- Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës
- Vërtetimin e tatimit në pronë
- Konfirmimin bankar
- Certifikatën që nuk jeni në hetime

5. Projektet që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetet jo-shumicë kanë përparësi.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikant, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Gjakovës (kk.rks-gov.net/gjakove/).

7. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Rr: "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

8. Vepra, dorëshkrim (e pa botuar), të dorëzohet e printuar dhe me CD, për komisionin vlerësues në pesë (5) kopje, në zyrat e **DKRS-së**, brenda afatit të thirrjes publike.

9. Afati për dorëzimin e propozimeve-kërkesave është nga data **17.08.2023**, deri më datën **06.09.2023, ora 16:00**

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.

Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në **zyrat e DKRS-së**.